



Ndërmarrja Publike Lokale **KASTRIOTI** Sh.A

Adresa: Rr. "Vashingtoni" pn - Obiliq
Tel: +383 46666607; +383 48777624
Email: nplkastrioti@gmail.com; web: www.nplkastrioti.com



Në bazë të dispozitave të Nenit 8 të Ligjit të Punës me nr 03/L-212, Ligjit për Ndërmarrje Publike me nr.03/L-087 dhe vendimit me nr prot.597/24 Ndërmarrja Publike Lokale "Kastrioti" Sh.A Obiliq, me datë 07.05.2024 shpall:

KONKURS

Për plotësimin e vendeve të punës

PUNËTOR FIZIK (Pastrues/e)

Numri i punëtorëve: 2

Përgatitja shkollore: Shkolla Fillore ose Shkolla e Mesme

Përvoja e punës: E dëshirueshme.

Punët dhe detyrat e punës:

- Kryen punët fizike për pastrimin e ndërtesave, objekteve publike të komunës së Obiliqit
- Është i obliguar të ketë sjellje korrekte duke respektuar kolegët
- Kryen të gjitha punët e caktura në kontratë
- Kryen dhe punë të tjera duke u bazuar në veprimtarinë e ndërmarjes dhe urdhëresave të eprorit
- Për punën e tij i përgjigjet drejtorit operativ.

Procedurat e Konkurrimit: Kandidati-ja për këto pozita duhet t'i dorëzojnë këto dëshmi:

- Dëshminë e kualifikimit,
- Kopjen e letërnjoftimit,
- Çertifikatën e cila dëshmon që nuk është i/e dënuar (jo më e vjetër se 6 muaj),
- Formulari i plotësuar i aplikimit.

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen përmes postës elektronike:

konkursetnplkastrioti@gmail.com

Kandidatët të cilët konkurrojnë duhet ta shënojnë saktë vendbanimin, numrin e telefonit kontaktues dhe e-mail adresën.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për intervistë.

Dokumentet e pa kompletuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

Konkursi është i hapur nga data 08.05.2024 deri më 22.05.2024

